



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kvalitetu, standardima i uspjehu

RAPORT PËRMBLEDHËS NGA VLERËSIMI

“KOLEGU KOLEGUN”

Viti akademik 2024/2025

Maj, 2025

1. Qëllimi i vlerësimit

Realizimi i vlerësimit përmes pyetësorit “kolegu kolegun” ka për qëllim promovimin e një kulture të hapur dhe bashkëpunuese mes stafit akademik, si dhe identifikimin e praktikave dhe aspekteve që kërkojnë përmirësim, me synimin për të garantuar cilësinë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përmbushur standardet e kulturës së cilësisë.

Procesi i vlerësimit përmes pyetësorit “**Kolegu – Kolegun**” përfaqëson një formë të vlerësimit të paraparë në Rregulloren për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në Universitetin “Haxhi Zeka”. Ky proces përfshinë monitorimin dhe vlerësimin e ligjëratave nga kolegët mësimdhënës në lëndën dhe lëmin e njëjtë ose të përafërt. Një gjë e tillë ka qëllim identifikimin e politikave të mësimdhënies të përdorura gjatë ligjërimit dhe gjithashtu dhënien e rekomandimeve për përmirësim.

Profesori vëzhgues merr pjesë në ligjëratat e kolegut dhe mbështetët në një pyetësor vlerësimi, përmes së cilit synohet të identifikohen praktikat efektive në: Organizimin e situatave të të nxënit dhe menaxhimit të kohës në mësim; Përdorimin e metodave që inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve; Shpjegimin e qartë të koncepteve dhe ideve kryesore; Zotërimin profesional të lëndës dhe lidhjen e saj me hulumtimet shkencore; Komunikimin e qartë dhe efektiv me studentët; Nxitjen e mendimit dhe analizës kritike gjatë procesit të të nxënit.

2. Procesi i vlerësimit

Vlerësimi përmes pyetësorit “Kolegu – Kolegun” në fakultete është realizuar gjatë periudhës 10 – 30 prill 2025. Në nivel universiteti janë vlerësuar gjithsej 82 staf akademik të rregullt, ndërsa 42 staf akademik të angazhuar. Gjatë hartimit të planit të vlerësimit, është marrë parasysh fusha akademike e secilit profesor vëzhgues, me qëllim që procesi i vëzhgimit dhe monitorimit të ligjëratave të jetë sa më efektiv. Në këtë mënyrë, rekomandimet e dhëna bazohen në ekspertizën specifike të profesorëve vlerësues, duke garantuar relevancë dhe cilësi më të lartë në ofrimin e sugjerimeve për përmirësim.

Tabela 1: Numri i vlerësimeve të kryera në Fakultetin e Biznesit

Fakulteti i Biznesit	Stafi akademik i rregullt i vlerësuar	31
	Stafi akademik i angazhuar i vlerësuar	17

Tabela 2: Numri i vlerësimeve të kryera në Fakultetin MTHM

Fakulteti MTHM	Stafi akademik i rregullt i vlerësuar	14
	Stafi akademik i angazhuar i vlerësuar	1

Tabela 3: Numri i vlerësimeve të kryera në Fakultetin Juridik

Fakulteti Juridik	Stafi akademik i rregullt i vlerësuar	8
	Stafi akademik i angazhuar i vlerësuar	/

Tabela 4: Numri i vlerësimeve të kryera në Fakultetin e Agrobiznesit

Fakulteti i Agrobiznesit	Stafi akademik i rregullt i vlerësuar	18
	Stafi akademik i angazhuar i vlerësuar	11

Tabela 5: Numri i vlerësimeve të kryera në Fakultetin e Arteve

Fakulteti i Arteve	Stafi akademik i rregullt i vlerësuar	11
	Stafi akademik i angazhuar i vlerësuar	13

3. Analiza e rezultateve të pyetësorit

Pyetësi i vlerësimit ka përbajtur gjithsej 8 pyetje të formuluar me shkallë vlerësimi nga 1 deri në 5, ku 1 nënkupton nivelin më të ulët dhe 5 nivelin më të lartë të performancës së vlerësuar. Rezultatet për të gjitha njësitë akademike, përfshirë mesataren e të gjitha vlerësimeve të realizuara, paraqiten në tabelarin më poshtë:

Nr.	Pyetjet	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Organizon në mënyrë efektive situatat e të nxëniet për të përbushur ligjëratën/ushtrimin e mbajtur në klasë	0	0	1	3	120
2	Përdor metoda mësimore duke inkurajuar pjesëmarrjen përkatëse të nxënësve në procesin mësimor	0	0	0	8	116
3	Shpjegon idetë e rëndësishme thjeshtë dhe qartë	0	0	1	6	117
4	Demonstron zotërim të lëndës duke përdorur edhe hulumtimet dhe gjetjet nga punimet e tij/saj	0	0	1	27	96
5	Komunikon në mënyrë të qartë dhe efektive në nivelin e studentëve	0	0	2	5	117
6	Përgjigjet në mënyrë të përshtatshme ndaj pyetjeve dhe komenteve të studentëve	0	0	0	5	119
7	Përdor në mënyrë efektive kohën e mësimit	0	0	2	8	114
8	Nxit mendimin dhe analizën kritike	0	0	0	15	109

REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM NGA KËSHILLI PËR MENAXHIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM

- Rekomandohet personeli akademik që të rrisin interaktivitetin me studentë.
Afati kohor: I menjëhershëm!
- Rekomandohet personeli akademik që të integrojnë shëmbuj praktik dhe raste studimore.
I menjëhershëm!
- Rekomandohet personeli akademik që të përdorin teknologji dhe burime moderne (aplikimi i software-ve të specializuar (ERP, CRM, auditim, analiza strategjike)).
I menjëhershëm!